

VENDIM

Nr.1058, datë 21.10.2009

I NDRYSHUAR

PËR PËRCAKTIMIN E KUFIRIT MINIMAL TË REGJISTRIMIT PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR (TVSH)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 3 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) të jetë 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për vit kalendarik.

Ndërsa, për tatimpaguesit, që ofrojnë shërbime në veprimtari ekonomike, sipas profesioneve, të tilla si: avokat, noter, mjek i specializuar, dentist, dentist i specializuar, farmacist, infermier, mami, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabël i regjistruar, dhe kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë, si dhe në veprimtarinë ekonomike në fushën e hotelërisë, pavarësisht nga qarkullimi vjetor, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në hiqet dhe të gjithë janë subjekte të TVSH-së.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2010.

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 162, dt. 27.11.2009

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 shkurt 2011.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

***Ndryshuar me VKM nr. 149 datë 03.03.2010, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 33, datë 02.04.2010.

*** Ndryshuar me Vendimin nr. 18 date 12.01.2011, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 4, date 24.01.2011.